



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:249946

Datë: 09.09.2024

Numri i dokumentit: 06138289

C.nr.1882/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florid Hasku me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Haxhiavdyli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S. B. nga fshati . . . Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seancës, më 09 shtator 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit S. B. nga fshati . . . Komuna e Gjakovës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit për pjesën e mbetur, dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 30.01.2023, t’ia paguajë shumën prej 1,383.75 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 09.11.2023 (datë e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t’ia paguaj shumën prej 134.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 09.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të

ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura në shkollën “Zenel Sadiku” në fshatin . . . Komuna e Gjakovës, si mësimdhënës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që t’ia paguaj paditësit në bazë të kualifikimit për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datën 30.01.2023, shumën prej 1,383.75 euro, ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, me datën 29.04.2024, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetimin se paditësit nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësi dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditëses nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parashihet që punëtorëve të arsimit iu takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës se paditësit i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësi nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. E paditura ka theksuar se paditësit i ka skaduar edhe afati i licencës. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësin, të lëshuara nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësi i lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Zenel Sadiku” në fshatin Babaj Bokës Komuna e Gjakovës, si mësimdhënës. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat: 01.10.2021-31.01.2023, vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të

licencës për periudhën kontestuese i është paguar shuma prej 58.32 euro, në emër të kualifikimit. I njëjti ka marrë titullin Bachelor në Fakultetin e Edukimit me datën 14.07.2016, fakt që vërtetohet përmes Certifikatës (e lëshuar në vend të diplomës-përkohësisht) së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, në Prishtinë, me numër 1004/a. Po ashtu paditësi ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100007710. Gjykata provave të lartcekura iu falë besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, vendim i cili ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023, ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 3 e tij, ka përcaktuar se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, se i njëjti ka diplomë universitare me titull bachelor dhe po ashtu ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 30.01.2023 apo për 25 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumë të përgjithshme prej 1,383.75 euro, për këtë kriter të kompensimit.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se të njëjtit nga data 01.01.2021 e deri me datë 30.01.2023, për 25 muaj i është kompensuar shuma prej 58.32 euro për çdo muaj, mirëpo nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit shumë prej 55.35 euro për çdo muaj, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që

“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Kontrata Kolektive e Arsimit është shkëputur nga data 31.01.2023, andaj paditësit nuk i takon kompensimi për periudhën pas kësaj date, mirëpo këtë pretendim gjykata e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës se paditësi nuk ka licencë mirëpo ky pretendim ishte i pa bazuar përkatësisht jo relevant për të vendosur ndryshe në këtë çështje pasi që gjykata në rastin konkret e ka aprovuar kërkesëpadinë duke u bazuar mbi bazën e kualifikimit dhe jo mbi bazën e licencimit.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se kërkesa është e parashkruar në tërësi është i pabazuar, pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”,* e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 09.11.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre (3) viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 134.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 30.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1882/23, më 09 shtator 2024

Gj y q t a r

Florid Hasku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.